
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës: 03.05.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “INFINITT” sh.p.k. , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me enëlarëse dhe fshesa për larjen e tepihëve, me Nr. Prokurimit: 616 23 3132 136 me datë: 08.05.2023** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “INFINITT” sh.p.k. , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me enëlarëse dhe fshesa për larjen e tepihëve, me Nr. Prokurimit: 616 23 3132 136, kundër Njoftimit për Vendim të aktivitetit të AK –së, të datës 28.04.2023 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për rekomandim të dhënies lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me enëlarëse dhe fshesa për larjen e tepihëve, me Nr. Prokurimit: 616 23 3132 136.**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues me datë: 28.04.2023 ka bërë publik Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në sistemin elektronik E-Prokurimi lidhur me rekomandimin e dhënies për aktivitetin e prokurimit me titull:

Furnizim me enëlarëse dhe fshesa për larjen e tepihëve, me Nr. Prokurimit: 616 23 3132 136

Ju si Operator Ekonomik keni ushtruar të drejtën e juaj për Kërkesë për Rishqyrtim, pra me datë: 03.05.2023.

Pretendimet ankimore:

Kerkese per rishqyrtim paraqitet kunder njoftimit mbi vendimin AK-se te dates: 03.05.2023 pasi qe AK-Komuna e Prishtines ka shpallur oferten tone te papergjegjshme ne aspektin teknike te ofertes. Si OE ankues nuk pajtohem sepse Operatori Ekonomik i rekomanduar ROA CONSULTING për dhënie të kontratës ka dorëzuar autorizimin nga distributori DANFOS L.L.C. i cili nuk ka të drejtë të autorizuar për furnizimin e produkteve HUGO dhe si rrjedhojë distributor për furnizimin e brendit HUGO është kompania Aztech dhe Beko.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:

Autoriteti Publik ka bërë vlerësimin e ofertave në bazë të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores për Prokurimin Publik si dhe kriterëve të dosjes së tenderit.

Operatori Ekonomik ROA CONSULTING ka dorëzuar autorizimin nga distributori në përputhje të plotë me kriteret e dosjes së tenderit dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullave për Prokurimin Publik si dhe Kriterëve të Dosjes së Tenderit.

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

*Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik – E-Prokurimi
Arkivit*

ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT

